REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 584/25 Dt. 06.10.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur mes Komunës së Prizrenit dhe Flutura Academy, 01 nr. 575/25, të datës 29.09.2025 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit që ka për qëllim ofrimin e trajnimeve profesionale për fushat e teknologjisë informative, aktiviteteve sociale dhe kreative për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Prizrenit, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 4.2 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur mes Komunës së Prizrenit dhe Flutura Academy, 01 nr. 575/25, të datës 29.09.2025, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 20.000,00 € (njëzetë mijë euro).

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit të lidhur mes Komunës së Prizrenit dhe Flutura Academy, 01 nr. 575/25, të datës 29.09.2025.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës– pozicioni i subvencioneve dhe transfereve dhe pozicioni mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohen Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Flutura Academy,
- Arkivës së Kryetarit.